

## **KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË NËPUNËSIT E ADMINISTRATËS SHTETËRORE PËR STUDIMET MASTER**

1. Të jenë pranuar në njërin nga 300 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së fundit të përgjithshme ose në njërin nga 100 universitetet më të mira të botës sipas fushave, nga "Times Higher Education"- Renditja botërore e universiteteve, në vitin më të fundit, për të ndjekur në ciklin e dytë apo të tretë të studimit një program master me kohëzgjatje 1 vjeçare në fushat e mëposhtme:
  - Politika publike;
  - Administrim publik;
  - Politika ekonomike;
  - Politika arsimore;
  - Politika shëndetësore;
  - Urbanistikë dhe zhvillim urban;
  - Menaxhim i financave publike;
  - E drejtë administrative/publike;
  - Studime evropiane.
2. Të pranojnë që pas përfundimit të studimeve të kthehen dhe të punojnë për jo më pak se 4 (katër) vjet në Shqipëri, në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura apo njësi të qeverisjes vendore, në përputhje me profilin e studimeve të kryera të mbështetura financiarisht nga Fondi i Ekselencës;
3. Të kenë marrë aprovimin e titullarit të institucionit ku punojnë për kryerjen e studimeve jashtë vendit dhe aplikimin për përfitimin financiar nga Fondi i Ekselencës;
4. Të mos jenë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar;
5. Të mos përfitojnë bursë/financim të plotë në universitetin pritës apo nga donatorë të tjerë. Në rastet kur studenti përfiton një financim të pjesshëm nga universiteti pritës apo nga donatorë të tjerë, financimi nga Fondi i Ekselencës do të bëhet për diferencën e vlerës deri në vlerën maksimale të parashikuar nga ky fond.

### **DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESË KANDIDATI:**

#### **3. BURSA TË POSACME, PËR NËPUNËSIT E ADMINISTRATËS SHTETËRORE**

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga website i MASR [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al));
2. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë;
3. Miratimin e titullarit të institucionit të administratës shtetërore ku punon nëpunësi, sipas formatit të parashikuar në Shtojcën 3 të Udhëzimit nr 16 datë 1.08.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore", i ndryshuar.

EMBLEMA E INSTITUCIONIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

AUTORIZIM

Autorizoj Z/Znj. \_\_\_\_\_, të aplikojë në programin e Fondit të Ekselencës, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për mbështetje financiare për kryerjen e studimeve master, në fushën e \_\_\_\_\_ në universitetin \_\_\_\_\_.

Titullari i Institucionit

Firma

Vula